



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR  
SIPËRMARRJET DHE NËNFONDET KRYESORE E FURNIZUESE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 108, datë 30.06.2021*

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për shoqëritë administruese të fondeve, depozitarët dhe shoqëritë audituese në lidhje me veprimtarinë e sipërmarrjeve dhe nënfondeve të licencuara kryesore dhe furnizuese.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Rregullorja hartohet në bazë të neneve 139 deri 154 të Ligjit Nr.56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” janë të njëjta edhe për këtë rregullore.
2. Termi “Ligji” i referohet Ligjit Nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
3. Termi “Dokumenti themelues” i referohet pikës 18 të nenit 2 të Ligjit 56/2020.

**Neni 4**  
**Kushtet për investimet**

1. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi investon të paktën 85 % të aktiveve në kuota të një sipërmarrjeje tjetër të investimeve kolektive ose nënfondi tjetër (“sipërmarrja kryesore”), që është licencuar ose njohur në zbatim të Ligjit ose është licencuar nga një vend i miratuar nga Autoriteti, i cili ka në fuqi ligje që garantojnë një mbrojtje të investitorëve të njëjtë me atë të parashikuar në Ligj.
2. Sipërmarrja furnizuese ose nënfondi mban deri në 15 % të aktiveve të veta në mjete monetare dhe depozita pa afat.

**KREU II**  
**KËRKESA PËR MIRATIM TË SIK ME OFERTË PUBLIKE NË SIPËRMARRJE**  
**FURNIZUESE**

**Neni 5**  
**Kërkesa për miratim**

1. Kërkesa për licencim si sipërmarrje ose nënfond i investimeve kolektive kryesore ose furnizuese bëhet në përputhje me parashikimet e nenit 145 të Ligjit.
2. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike ndryshohet në sipërmarrje furnizuese, dokumentacioni i depozituar nga shoqëria administruese e kësaj sipërmarrje në Autoritet duhet të përmbajë sa më poshtë:
  - a) Dokumentin themelues të sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues dhe të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor;

- b) Vërtetim se sipërmarrja kryesore ose nënfondi kryesor është me ofertë publike në vendin e tij;
  - c) Prospektin SIK dhe dokumentin e informacionit kryesor të investitorëve të sipërmarrjes ose të nënfondit të furnizuesit dhe të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor;
  - d) Marrëveshjen ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje përveç sa parashikon ligji;
  - e) Marrëveshjen për shkëmbimin e informacionit në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje, përveç sa parashikon ligji, nëse sipërmarrja ose nënfondi kryesor ose sipërmarrja ose nënfondi furnizues kanë depozitar të ndryshëm;
  - f) Një deklaratë se investimi i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor do t'i kapërcejë kufijtë e përcaktuar, në zbatim të nën ndarjes "iv", të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 139, të Ligjit.
3. Në rastin kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor ose sipërmarrja ose nënfondi furnizues kanë shoqëri audituese të ndryshme, aplikimi për miratim duhet të shoqërohet gjithashtu me marrëveshjen për shkëmbimin e informacionit ndërmjet audituesve në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje.
4. Në rastin kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor është sipërmarrje investimesh kolektive në tituj të transferueshëm, aplikimi për miratim duhet të shoqërohet gjithashtu me një vërtetim nga shoqëria administruese e sipërmarrjes kryesore ose nënfondit të licencuar ose nga autoriteti rregullator i vendit që sipërmarrja ose nënfondi janë themeluar, që sipërmarrja e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm:
- a) Është një sipërmarrje investimesh kolektive në tituj të transferueshëm ose një nënfond i një sipërmarrjeje të tillë; dhe
  - b) Nuk është në vetvete një sipërmarrje furnizuese investimesh kolektive në tituj të transferueshëm ose nënfond i një sipërmarrjeje të tillë dhe nuk zotëron kuota të një sipërmarrjeje furnizuese të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm.
5. Në rastin kur sipërmarrja kryesore është e themeluar në një vend tjetër, kërkesa shoqërohet nga konfirmimi i autoritetit të huaj rregullator të vendit në fjalë, se sipërmarrja kryesore është në përputhje me rregullat e vendit të origjinës, që janë të barasvlershme me rregullat e parashikuara në këtë kre.
6. Kërkesa për miratim shqyrtohet nga Autoriteti brenda 3 muajve, pas depozitimit të dokumentacionit të plotë.

**KREU III**  
**KOORDINIMI NDËRMJET SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË SIPËRMARRJEVE**  
**KRYESORE DHE FURNIZUESE**

**Neni 6**

**Marrëveshja ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese  
dhe rregullat e ushtrimit të biznesit**

1. Shoqëria administruese e fondit të një sipërmarrjeje ose nënfondi furnizues duhet të lidhë një marrëveshje me shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, e cila, minimalisht përputhet me përmbajtjen e kërkuar të marrëveshjes sipas Shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.
2. Në rast se sipërmarrja kryesore dhe sipërmarrja furnizuese ose nënfondet administrohen nga e njëjta shoqëri administruese, kjo marrëveshje mund të zëvendësohet me procedura të brendshme, të ushtrimit të biznesit të cilat minimalisht duhet të jenë në përputhje me Shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.
3. Shoqëria administruese e fondeve të një sipërmarrjeje ose nënfondi furnizues nuk investon në kuota të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor që tejkalojnë kufirin e zbatueshëm sipas nenit 140, pikës 1, shkronja dh) të Ligjit për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike nga momenti i miratimit nga Autoriteti dhe deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjeve të mëposhtme:
  - a) Marrëveshja ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese sipas pikës 1 të këtij neni, ose, nëse është e zbatueshme sipas pikës 2 të këtij neni, rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit;
  - b) Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve në përputhje me nenin 15 të kësaj rregulloreje;
  - c) Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet shoqërive audituese në përputhje me nenin 18 të kësaj rregulloreje.
4. Një kopje e marrëveshjes ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizues ose, kur është e zbatueshme, rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit, ju vihet në dispozicion mbajtësve të kuotave me kërkesën e tyre dhe pa pagesë nga shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues.

## **Neni 7**

### **Ligji i zbatueshëm për marrëveshjet ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese**

1. Kur sipërmarrja ose nënfondi furnizues dhe sipërmarrja ose nënfondi kryesor janë themeluar të dyja në Shqipëri, marrëveshja ndërmjet shoqërive administruese të tyre, duhet të parashikojë se për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje zbatohet ligji shqiptar.
2. Kur sipërmarrjet kryesore dhe furnizuese themelohen në vende të ndryshme, marrëveshja duhet të parashikojë që ligji i zbatueshëm të jetë:
  - a) Ligji i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi furnizues; ose
  - b) Ligji i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi kryesor, dhe që të dyja palët bien dakord që i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave të vendit që është përcaktuar në marrëveshje.

## **Neni 8**

### **Përcaktimi i kohës së llogaritjes dhe publikimit të vlerës neto të aktiveve**

Shoqëritë administruese të fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor dhe sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ndërmarrin masat e duhura për të bashkërenduar kohën e llogaritjes dhe publikimit të vlerës neto të aktiveve të tyre, duke përfshirë publikimin e çmimeve të shitjes, me qëllim që të shmangët strategjia e parashikimit të tregut në kuotat e tyre, duke parandaluar mundësitë e arbitrazhit.

## **Neni 9**

### **Detyrimet e shoqërisë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues**

1. Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të monitorojë efektivisht veprimtarinë e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor.
2. Në përmbushjen e këtij detyrimi, shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues mund të mbështetet në informacionet dhe dokumentet e ofruara nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, ose sipas rastit, nga depozitari ose shoqëria audituese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, me përjashtim të rastit kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme për saktësinë e tyre.

## **Neni 10**

### **Incentivat**

Nëse shoqëria administruese ose çdo person tjetër, që vepron në emër të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese ose shoqërisë administruese të nënfondit apo sipërmarrjes furnizuese merr tarifë shitjeje, komisione ose përfitime të tjera monetare, kjo tarifë, komision apo përfitim tjetër monetar kalohet në aktivet e nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese.

### **Neni 11** **Detyrimi për informim**

1. Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit të licencuar kryesor njofton menjëherë Autoritetin për identitetin e secilës sipërmarrje furnizuese që investon në kuotat e saj.
2. Kur Autoriteti informohet sipas pikës 1 të këtij neni, që sipërmarrja furnizuese e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm e themeluar në një vend tjetër ka investuar në kuotat e sipërmarrjes kryesore së licencuar të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm ose nënfondin e kësaj sipërmarrjeje, Autoriteti informon menjëherë autoritetin rregullator në vendin e origjinës të sipërmarrjes furnizuese.

### **Neni 12** **Mos aplikimi i tarifave shtesë për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues**

Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor nuk duhet të vendosë asnjë tarifë hyrjeje ose daljeje në sipërmarrjen ose nënfondin furnizues për dhënien, shitjen, shlyerjen ose anulimin e kuotave në sipërmarrjen ose në nënfondin kryesor.

### **Neni 13** **Detyrimi për dhënien e informacionit**

Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor garanton dhënien në kohë të të gjithë informacionit që kërkohet në përputhje me detyrimet e tij sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje, dhe dokumentit themelues të sipërmarrjes, subjekteve të mëposhtme:

- a) Shoqërisë administruese të sipërmarrjes furnizuese;
- b) Autoritetit rregullator të sipërmarrjes furnizuese;
- c) Depozitarit të sipërmarrjes furnizuese; dhe
- d) Shoqëria audituese e sipërmarrjes furnizuese.

## Neni 14

### Detyrimet e shoqërisë administruese të sipërmarrjes kryesore ndaj mbajtësve të kuotave

1. Shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes që vepron ose synon të veprojë si sipërmarrje ose nënfond kryesor nënshkruan marrëveshje ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese ose, nëse është e zbatueshme, harton rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje, vetëm kur e gjykon se ka baza të arsyeshme për të besuar se marrëveshja me shoqërinë administruese të sipërmarrjes furnizuese nuk cenon në mënyrë të padrejtë interesat e asnjë mbajtësi kuotash ose klase mbajtësish kuotash në sipërmarrjen kryesore.
2. Shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes që vepron ose synon të veprojë si sipërmarrje ose nënfond kryesor duhet të informojë mbajtësit e kuotave të sipërmarrjes kryesore, përveç mbajtësve të kuotave të sipërmarrjes furnizuese, në mënyrë të përshtatshme dhe në të njëjtën kohë, me qëllim mos cenimin e interesave të tyre, duke e informuar mbi:
  - a) Çdo informacion që i vë në dispozicion shoqërisë administruese të fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues; dhe
  - b) Çdo çështje të njoftuar nga depozitari i sipërmarrjes kryesore.
3. Kur shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes kryesore nuk njofton mbajtësit e kuotave në të njëjtën kohë në lidhje me çështjet e përmendura në shkronjën b) të pikës 2 të këtij neni, atëherë kjo shoqëri duhet të:
  - a) Specifikojë arsyet përse interesat e këtyre mbajtësve të kuotave nuk cenohen në mënyrë të padrejtë nga vendimi i saj; dhe
  - b) Informojë të gjithë mbajtësit e kuotave në lidhje me këtë çështje në mënyrë dhe afate kohore të përshtatshme, por jo më vonë se fundi i ditës së punës kur është ngritur çështja.
4. Mënyra dhe afati kohor i përshtatshëm i njoftimit të mbajtësve të kuotave i parashikuar në pikën 3, shkronja b) të këtij neni varet nga natyra dhe rëndësia e çështjes. Shoqëria administruese e fondit duhet të vlerësojë çdo çështje në mënyrë individuale.
5. Mënyrat e përshtatshme të njoftimit, mund të përfshijë dërgimin e njoftimit të menjëhershëm të mbajtësit e kuotave, ose mundësimin e publikimit të informacionit të një ose më shumë faqe interneti që janë të mundshme të shihen nga investitorët.

**KREU IV**  
**KËRKESAT NË LIDHJE ME DEPOZITARËT E SIPËRMARRJEVE DHE**  
**NËNFONDEVE KRYESORE DHE FURNIZUESVE**

**Neni 15**

**Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve**

1. Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues është përgjegjëse për komunikimin e çdo informacioni depozitarit të sipërmarrjes ose të nënfondeve në lidhje me këtë sipërmarrje ose nënfond, informacion që kërkohet për përmbushjen e detyrimeve rregullatore të depozitarit.
2. Nëse sipërmarrjet kryesore ose nënfondet dhe sipërmarrjet furnizuese nuk kanë të njëjtin depozitar, depozitarët duhet të lidhin marrëveshje për shkëmbimin e informacionit për të siguruar që të dy të jenë në gjendje t'i kryejnë detyrimet e tyre. Marrëveshja zbatohet duke filluar nga data kur sipërmarrja furnizuese ose nënfondi fillon të investojë në nënfondin ose sipërmarrjen kryesore.

**Neni 16**

**Përmbajtja e marrëveshjes së shkëmbimit të informacionit ndërmjet depozitarëve**

1. Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit të referuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje përfshin sa më poshtë:
  - a) Identifikimin e dokumenteve dhe kategorive të informacionit të cilat duhet të shkëmbehen në mënyrë rutinore ndërmjet dy depozitarëve, dhe nëse ky informacion ose këto dokumente i mundësohen njërit depozitar nga depozitari tjetër apo nëse vihen në dispozicion sipas kërkesës;
  - b) Mënyrën dhe afatet kohore, duke përfshirë çdo afat të zbatueshëm, të transmetimit të informacionit nga depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor te depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues;
  - c) Bashkërendimi i përfshirjes së dy depozitarëve, në masën e duhur në funksion të detyrave të tyre përkatëse sipas ligjit në fuqi, në lidhje me çështjet operationale, duke përfshirë:
    - i) Procedurën për llogaritjen e vlerës së aktiveve neto të secilës sipërmarrje ose nënfond, duke përfshirë çdo masë të përshtatshme për tu mbrojtur nga aktivitetet e strategjisë së parashikimit të tregut duke parandaluar mundësitë e arbitrazhit;
    - ii) Përpunimin e udhëzimeve nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues për të blerë, nënshkruar ose kërkuar riblerjen ose shlyerjen e kuotave në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor dhe shlyerjen e këtyre transaksioneve, përfshirë çdo rregull/masë për transferimin e aktiveve në natyrë;



- iii) Bashkërendimin e procedurave financiare dhe të kontabilitetit në fund të vitit;
  - iv) Detaje të shkeljeve, nga aktiviteti i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, të ligjit ose rregulloreve dhe dokumentit themelues të sipërmarrjes, duhen t'i njoftohen depozitarit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues nga depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, dhe si dhe kur duhet të jepen këto detaje;
  - v) Procedurën për trajtimin e kërkesave *ad-hoc* për asistencë nga një depozitar në tjetrin; dhe
  - vi) Identifikimin e ngjarjeve të mundshme të cilat duhet të njoftohen nga një depozitar në tjetrin në baza *ad-hoc*, dhe si dhe kur do të bëhet kjo.
2. Në rastin kur ekziston një marrëveshje ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese në përputhje me rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit, marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve duhet të përfshijë sa më poshtë:
- a) Ligjin e vendit i cili do të jetë i zbatueshëm për marrëveshjen ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese, ligj që do të zbatohet gjithashtu për marrëveshjen e shkëmbimit të informacionit; dhe
  - b) Të dy depozitarët bien dakord për juridiksionin ekskluziv të gjykatave të atij vendi.
3. Kur marrëveshja ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese është zëvendësuar me rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit, marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve duhet të përfshijë sa më poshtë:
- a) Ligji që zbatohet për marrëveshjen e shkëmbimit të informacionit do të jetë ose ai i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi furnizues ose, kur janë të ndryshme, ai i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi kryesor; dhe
  - b) Të dy depozitarët bien dakord për juridiksionin ekskluziv të gjykatave të vendit, ligji i të cilit është i zbatueshëm për marrëveshjen e shkëmbimit të informacionit.

## **Neni 17**

### **Njoftimi i parregullsive**

1. Në rastin kur depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor zbulon ndonjë parregullsi në lidhje me sipërmarrjen ose nënfondin, e cila mund të ketë një ndikim negativ në sipërmarrjen përkatëse furnizuese, depozitari njofton menjëherë sa më poshtë:
- a) Autoritetin rregullator përkatës të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor si dhe të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues;
  - b) Shoqërinë administruese të fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ose, sipas rastit; edhe
  - c) Depozitarin e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues.

2. Parregullsitë e përmendura në pikën 1 të këtij neni përfshijnë sa më poshtë, por jo vetëm:
  - a) Gabime në vlerësimin e aktiveve të kryera në pajtim me ligjin;
  - b) Gabimet në transaksionet për shlyerjen e shitjes, emetimit, riblerjes ose shlyerjes së kuotave në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor, të ndërmarra nga sipërmarrja ose nënfondi furnizues;
  - c) Gabime në pagesën ose regjistrimin e të ardhurave që rrjedhin nga investimet e sipërmarrjes ose të nënfondit ose në llogaritjen e ndonjë tatimi në burim të lidhur me të ardhurat;
  - d) Shkelje të objektivave, politikës ose strategjisë së investimit, të sipërmarrjes ose nënfondit siç përcaktohet në dokumentin themelues të sipërmarrjes ose nënfondit, në prospektin SIK ose në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit; dhe
  - e) Shkeljet e kufijve të investimeve dhe të huamarrjes të përcaktuara në ligj, në Rregulloren “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”, në dokumentin themelues, në prospektin SIK ose në dokumentin e informacionit kryesor të investitorit të sipërmarrjes ose të nënfondit.
3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, depozitari i sipërmarrjes ose i nënfondit kryesor duhet gjithashtu të informojë depozitarin e sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues se si sipërmarrja ose nënfondi kryesor ose shoqëria e tij administruese e fondit ka zgjidhur ose propozon të korrigjojë parregullsinë.
4. Në rastin kur depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues informohet nga depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor në lidhje me një parregullsi dhe mendon që zgjidhja e propozuar nuk është në interes të zotëruesve të kuotave, atëherë ai duhet të njoftojë menjëherë shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues, në lidhje me opinionin e tij.
5. Në rast se depozitari i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues nuk është dakord me zgjidhjen e parregullsisë sipas pikës 4 të këtij neni, atëherë depozitari e raporton këtë në Autoritet dhe tek autoriteti i jashtëm rregullator i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi kryesor.

**KREU V**  
**KËRKESAT QË LIDHEN ME SHOQËRITË AUDITUESE TË SIPËRMARRJEVE**  
**KRYESORE DHE FURNIZUESE**

## Neni 18

### Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet shoqërive audituese

Në rastin kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor dhe sipërmarrja ose nënfondi furnizues kanë shoqëri audituese të ndryshme, këto shoqëri audituese duhet të lidhin një marrëveshje për shkëmbimin e informacionit me qëllim që të sigurojnë përmbushjen e detyrave të tyre përkatëse.

## Neni 19

### Përmbajtja e marrëveshjes së shkëmbimit të informacionit ndërmjet shoqërive audituesve

1. Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit e përcaktuar në nenin 18 të kësaj rregulloreje përfshin sa më poshtë:
  - a) Identifikimin e dokumenteve dhe kategorive të informacionit të cilat duhet të shkëmben në mënyrë rutinore ndërmjet dy shoqërive audituese;
  - b) Nëse informacioni ose dokumentet e përcaktuara në shkronjën a), të kësaj pike, i dërgohen njëres shoqëri audituese nga shoqëria audituese tjetër, menjëherë sapo janë përgatitur apo nëse i vihen në dispozicion me kërkesë;
  - c) Mënyrën dhe afatet kohore, duke përfshirë çdo afat të zbatueshëm, të transmetimit të informacionit nga shoqëria audituese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor te shoqëria audituese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues;
  - d) Bashkëndimi i përfshirjes të çdo shoqërie audituese në procedurat e kontabilitetit të fundvitit për sipërmarrjen e tyre përkatëse;
  - e) Specifikimi i çështjeve që duhet të trajtohen si parregullsi dhe të paraqitura në raportin e auditimit për sipërmarrjen kryesore për qëllime të nenit 20 të kësaj rregulloreje;
  - f) Mënyrën dhe kohën për trajtimin e kërkesave *ad-hoc* për asistencë nga një auditues tek tjetri, përfshirë kërkesën për informacione të mëtejshme për parregullsitë e përfshira në raportin e auditimit për sipërmarrjen ose nënfondin kryesor; dhe
  - g) Dispozita në lidhje me përgatitjen e raporteve të auditimit të referuara në nenin 20 të kësaj rregulloreje dhe mënyrën dhe afatin kohor për mundësimin e raportit të auditimit të sipërmarrjes dhe nënfondit kryesor (dhe draftet e tij), shoqërisë audituese të sipërmarrjes ose nën fondit furnizues.
2. Nëse sipërmarrjet nuk kanë të njëjtin vit financiar, shoqëria audituese e nënfondit ose sipërmarrjes kryesore harton një raport të përkohshëm, në datën e bilancit të nënfondit ose sipërmarrjes furnizuese. Marrëveshja për shkëmbimin e informacionit përfshin mënyrën dhe kohën në të cilën shoqëria audituese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor duhet të hartojë një raport *ad-hoc* të auditimit sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje dhe t'ia paraqesë atë (dhe draftet e tij) shoqërisë audituese të sipërmarrjes furnizuese.

3. Në rastin kur ekziston një marrëveshje ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese, marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet shoqërive audituesve duhet të përfshijë sa më poshtë:
  - a) Që ligji i vendit të zbatueshëm për marrëveshjen ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese do të zbatohet edhe për marrëveshjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet audituesve; dhe
  - b) Të dy shoqëritë audituese të bien dakord për juridiksionin ekskluziv të gjykatave të atij vendi.
  
4. Nëse marrëveshja ndërmjet shoqërive administruese të sipërmarrjeve kryesore dhe furnizuese është zëvendësuar me rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit, marrëveshja për shkëmbimin e informacionit ndërmjet shoqërive audituese duhet të përfshijë sa më poshtë:
  - a) Ligji që zbatohet për marrëveshjen e shkëmbimit të informacionit do të jetë ose ai i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi furnizues ose, kur janë të ndryshme, ai i vendit në të cilin është themeluar sipërmarrja ose nënfondi kryesor; dhe
  - b) Të dy shoqëritë audituese bien dakord për juridiksionin ekskluziv të gjykatave të atij vendi.

## **Neni 20**

### **Përgatitja e raportit të auditimit**

Gjatë përgatitjes së raportit të auditimit, shoqëria audituese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të marrë parasysh:

- a) Raportin e auditimit të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor; dhe
- b) Se raporti i sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit përshkruan parregullsitë e shtjelluara në raportin e auditimit të sipërmarrjes kryesore ose nënfondit dhe shoqëria audituese e sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit jep opinion për rëndësinë që kanë këto parregullsi për sipërmarrjen furnizuese ose nënfondin; dhe
- c) Se respektimi i detyrimeve të përcaktuara mbi shoqërinë audituese, në zbatim të këtij neni, nuk konsiderohet shkelje e detyrimit për ruajtje të fshehtësisë së informacionit, në zbatim të këtij ligji, akteve nënligjore ose marrëveshjes dhe nuk e ngarkojnë me përgjegjësi audituesin apo këdo që vepron në emër të audituesit.

## **Neni 21**

### **Përgjegjësia e shoqërive administruese të fondeve në lidhje me auditimin**

Shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor ose furnizues siguron që kushtet sipas të cilave caktohen shoqëritë audituese të sipërmarrjeve ose nënfondeve përkatëse të parashikojnë pajtueshmërinë e çdo shoqërie audituese me dispozitat e këtij Kreu.

## **KREU VI**

### **LIKUIDIMI DHE MBYLLJA E SIPËRMARRJEVE DHE NËNFONDEVE KRYESORE DHE FURNIZUESVE**

#### **Neni 22**

#### **Mbyllja dhe likuidimi**

1. Përveç kërkesave të Kreut XI të Ligjit Nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe Rregullores nr. 189, datë 16.12.2020 “Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve”, për likuidimin dhe mbylljen e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ose kryesor zbatohen edhe dispozitat e këtij kreu.
2. Fillimi i mbylljes së sipërmarrjes kryesore kryhet jo më vonë se 3 muaj pas njoftimit të mbajtësve të kuotave dhe, kur është e zbatueshme, të autoritetit rregullator të vendit të origjinës të sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues, duke i informuar ata për vendimin e detyrueshëm të mbylljes së sipërmarrjes kryesore.

#### **Neni 23**

#### **Kërkesa për miratim nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues në rastet kur mbyllet sipërmarrja kryesore**

1. Kur shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues vihet në dijeni që sipërmarrja e saj kryesore duhet të mbyllet, ajo paraqet në Autoritetin rregullator përkatës të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues sa më poshtë:
  - a) Kur shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes furnizuese synon të investojë minimalisht 85% të vlerës së sipërmarrjes furnizuese në kuotat e një sipërmarrjeve ose nënfondi tjetër kryesor:
    - i) Kërkesën e saj për miratimin e këtij investimi;
    - ii) Ndryshimet në prospektin SIK dhe dokumentin e informacionit kryesor për investitorët;
    - iii) Dokumentet e tjera të kërkuara në përputhje me nenin 5 të kësaj rregulloreje;

- b) Kur shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ka për qëllim ta shndërrojë atë në një sipërmarrje që nuk është një sipërmarrje ose nënfond furnizues:
    - i) Aplikimin e saj për miratimin e ndryshimeve të propozuara të dokumentit themelues; dhe
    - ii) Ndryshimet në prospektin SIK dhe dokumentin e informacionit kryesor për investitorët;
  - c) Kur shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes furnizuese synon të mbyllë sipërmarrjen, njofton sipas nenit 19 të Rregullores nr. 189, datë 16.12.2020 "Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve".
2. Kërkesa për miratim shqyrtohet nga Autoriteti brenda 3 muajve, pas depozitimit të dokumentacionit të plotë.

#### **Neni 24**

##### **Afatet kohore të aplikimit**

1. Informacioni sipas nenit 23 të këtij Kreu dorëzohet në Autoritet jo më vonë se një muaj pas datës së njoftimit nga ana e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor të shoqërisë administruese të fondit të sipërmarrjes furnizuese për vendimin e detyrueshëm të mbylljes.
2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor ka njoftuar shoqërinë e administrimit të fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues për vendimin e detyrueshëm të mbylljes më shumë se pesë muaj përpara datës së fillimit të procedurave të mbylljes, shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese duhet t'ia dorëzojë informacionin Autoritetit jo më vonë se tre muaj përpara datës së fillimit të procedurave të mbylljes.

#### **Neni 25**

##### **Kërkesa për miratim në Autoritet nga shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese në rastet e bashkimit ose ndarjes së sipërmarrjes kryesore**

1. Nëse shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues vihet në dijeni se sipërmarrja ose nënfondi kryesor duhet të bashkohet me një sipërmarrje ose një nënfond tjetër ose të ndahet në dy ose më shumë sipërmarrje ose nënfonde, ajo paraqet në Autoritet sa më poshtë:

- a) Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes furnizuese ka për qëllim që të vazhdojë të jetë sipërmarrja furnizuese e së njëjtës sipërmarrje kryesore:
  - i) Aplikimin për miratim;
  - ii) Nëse është e aplikueshme, një njoftim për çdo ndryshim të propozuar të dokumentit themelues të sipërmarrjes ose të nënfondit;
  - iii) Nëse është e aplikueshme, ndryshimet në prospektin SIK dhe në informacionin kryesor të investitorëve të sipërmarrjes ose nënfondit.
- b) Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues synon që ajo të bëhet një sipërmarrje ose një nën fond furnizues i një tjetër sipërmarrjeje ose nënfondi tjetër kryesor, që rezulton nga bashkimi ose ndarja e propozuar e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, ose synon që sipërmarrja ose nënfondi kryesor të investojë të paktën 85% të vlerës së aktiveve në kuotat e një sipërmarrjeje ose nënfondi tjetër kryesor që nuk rezulton nga bashkimi ose ndarja:
  - i) Kërkesën e saj për miratimin e këtij investimi;
  - ii) Nëse është e aplikueshme, një njoftim për çdo ndryshim të propozuar të dokumentit themelues të sipërmarrjes ose të nënfondit;
  - iii) Ndryshimet në prospektin SIK dhe në informacionin kryesor të investitorëve të sipërmarrjes ose nënfondit;
  - iv) Ose çdo dokument tjetër të kërkuar nga Autoriteti.
- c) Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ka për qëllim ta shndërrojë atë në një sipërmarrje që nuk është një sipërmarrje ose nënfond furnizues:
  - i) Aplikimin për miratim të çdo ndryshimi të propozuar të dokumentit themelues të sipërmarrjes ose të nënfondit;
  - ii) Ndryshimet në prospektin SIK dhe në dokumentin e informacionit kryesor të investitorëve të sipërmarrjes ose nënfondit.
- d) Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes furnizuese synon të mbyllë sipërmarrjen, njoftimi bëhet sipas Seksionit 1 të Kreut 3 të Rregullores nr. 189 datë 16.12.2020 "Mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike, si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve" dhe pikës 3 të nenit 174 të Ligjit.

- 2. Sipërmarrja ose nënfondi furnizues konsiderohet nga Autoriteti se vazhdon të jetë sipërmarrja ose nënfondi furnizues i së njëjtës sipërmarrje ose nënfondi kryesor, nëse:
  - a) Sipërmarrja ose nënfondi kryesor është sipërmarrja marrëse në një bashkim të propozuar; ose
  - b) Sipërmarrja kryesore nuk ndryshon në mënyrë të konsideruar në ndarjen e propozuar.

3. Sipërmarrja furnizuese do të konsiderohet nga Autoriteti se shndërrohet në një sipërmarrje ose nënfond furnizues i një sipërmarrjeje tjetër kryesore që rezulton nga bashkimi ose ndarja e sipërmarrjes kryesore nëse:
  - a) Sipërmarrja kryesore është sipërmarrja e bashkimit dhe, si rezultat i bashkimit, sipërmarrja furnizuese bëhet mbajtës kuotash në sipërmarrjen marrëse;
  - b) Sipërmarrja furnizuese si rezultat i ndarjes bëhet mbajtës kuotash në një sipërmarrje që është në mënyrë të konsiderueshme e ndryshme nga sipërmarrja kryesore.
4. Kërkesa për miratim shqyrtohet nga Autoriteti brenda 3 muajve, pas depozitimit të dokumentacionit të plotë.

### **Neni 26**

#### **Afatet kohore të aplikimit për miratim në Autoritet të bashkimit ose ndarjes së sipërmarrjes apo nënfondit kryesor**

1. Informacioni i përcaktuar në nenin 25 të kësaj rregulloreje dorëzohet në Autoritet sapo shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues të ketë marrë informacionin e bashkimit apo ndarjes së planifikuar.
2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor ka njoftuar shoqërinë e administrimit të fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues, katër muaj përpara datës së propozuar të hyrjes në fuqi të bashkimit ose ndarjes, shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet t'ia dorëzojë informacionin Autoritetit jo më vonë se tre muaj përpara datës së propozuar të hyrjes në fuqi.

### **Neni 27**

#### **Riblerja ose shlyerja e kuotave në sipërmarrjen kryesore**

1. Nëse sipërmarrja ose nënfondi kryesor bashkohet me një sipërmarrje ose një nënfond tjetër kryesor, sipërmarrja kryesore ka detyrimin t'i riblejë të gjitha kuotat e sipërmarrjes ose nënfondit të saj furnizues, nëse ky i fundit vendos t'i shlyejë ato. Ky veprim duhet të ndodhë përpara se pasojat e shkrirjes të bëhen efektive, përveç rastit nëse Autoriteti miraton investimin e vazhdueshëm nga sipërmarrja furnizuese në sipërmarrjen kryesore që rezulton nga bashkimi.
2. Nëse Autoriteti nuk miraton investimin e vazhdueshëm në sipërmarrjen kryesore, shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të ushtrojë të drejtën për shlyerjen e kuotave të sipërmarrjes ose nën fondit furnizues në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor.



3. Shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes furnizuese duhet të ushtrojë të drejtën sipas pikës 1 të këtij neni, për të garantuar gjithashtu të drejtën e mbajtësve të kuotave që të kërkojnë shlyerjen e kuotave të tyre.
4. Para ushtrimit të së drejtës të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shoqëria administruese e fondeve të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të shqyrtojë çdo zgjidhje alternative me qëllim shmangien ose zvogëlimin e kostove të transaksionit ose ndikimet e tjera negative për mbajtësit e kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues.
5. Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes furnizuese kërkon riblerje ose shlyerje në përputhje me pikën 1 të këtij neni, asaj duhet t'i mundësohet sa më poshtë:
  - a) Të ardhurat e riblerjes ose të shlyerjes në mjete monetare; ose
  - b) Disa ose të gjitha të ardhurat e riblerjes ose të shlyerjes si një transferim në natyrë, nëse prospekti, dokumenti themelues i sipërmarrjes ose nënfondit furnizues dhe marrëveshja kryesor-furnizues e parashikojnë këtë në përputhje me Ligjin.
6. Në rast të zbatimit të pikës 5, shkronjës b) të këtij neni, shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues mund të shndërrojë në para, në çdo kohë, çdo pjesë të aktiveve të transferuara.

## **Neni 28**

### **Kushtet për riinvestimin e mjeteve monetare**

Pas marrjes së miratimit nga Autoriteti të kërkesës së shoqërisë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues, në rastet e mbylljes, bashkimit ose ndarjes së sipërmarrjes kryesore, shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues nuk mund t'i riinvestojë mjetet monetare, deri sa këto mjete monetare të investohen sipas objektivave dhe politikave të reja të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues, përveç me qëllim administrimin efikas të mjeteve monetare.

## **Neni 29**

### **Kërkesat pas miratimit nga Autoriteti**

Nëse shoqëria administruese e fondit të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ka dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas kësaj rregulloreje me qëllim mbylljen, ndarjen ose bashkimin dhe ka marrë njoftim me shkrim nga Autoriteti për miratimin e kërkuar, ajo vepron si më poshtë:

- a) Informon shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor në lidhje me këto miratime; dhe
- b) Merr masat e nevojshme për të përmbushur kërkesat brenda një muaji.

### **Neni 30**

#### **Njoftimi nga shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese**

Shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese përveç se njofton Autoritetin brenda 3 muajve përpara datës së propozuar për mbylljen e sipërmarrjes, në përputhje me nenin 174 të Ligjit, njofton edhe:

- a) Mbajtësit e kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues; dhe
- b) Shoqërinë administruese të fondit të sipërmarrjes kryesore;

### **Neni 31**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj.

## **SHTOJCA 1**

### **PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES KRYESOR-FURNIZUES**

Marrëveshja duhet të përmbajë:

1. Dispozitat që kanë të bëjnë me dhënien e informacionit nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor të shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues duhet të përmbajnë sa më poshtë:
  - a) Mënyrën dhe afatin kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor i mundëson shoqërisë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues një kopje të dokumentit themelues të sipërmarrjes ose nënfondit, të prospektit SIK dhe të dokumentit të informacionit kryesor të investitorit ose të ndryshimeve të tyre;
  - b) Mënyrën dhe afatin kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor informon shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues mbi delegimin të palët e treta të funksioneve të administrimit të investimeve dhe të administrimit të rrezikut;
  - c) Atje ku është aplikueshme, mënyrën dhe afatin kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor i mundëson shoqërisë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues dokumentet e brendshme operationale, të tilla si procesi i administrimit të rrezikut dhe raportet e saj të pajtueshmërisë;
  - d) Detajet e shkeljeve nga aktiviteti i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor që duhen t'i njoftohen shoqërisë administruese të sipërmarrjes furnizuese, si dhe mënyrën dhe kohën e njoftimit të këtyre shkeljeve të:
    - i. Ligjit;
    - ii. Dokumentit themelues; dhe
    - iii. Marrëveshjes kryesor-furnizues.
  - e) Nëse sipërmarrja furnizuese përdor derivativë për qëllime mbrojtjeje, mënyrën dhe kohën kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor i mundëson shoqërisë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues informacionin për ekspozimin aktual të derivativëve, në mënyrë që sipërmarrja furnizuese të llogarisë ekspozimin e saj global;
  - f) Deklaratën që shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor duhet të informojë shoqërinë administruese të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues për çdo marrëveshje tjetër të shkëmbimit të informacionit të nënshkruar me palët e treta dhe, nëse është e zbatueshme, mënyrën dhe kohën kur shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor i vë në dispozicion shoqërisë administruese të sipërmarrjes furnizuese këto marrëveshje të tjera të shkëmbimit të informacionit.
2. Dispozitat që kanë të bëjnë me bazën e investimit dhe shitjes nga ana e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues:

- a) Deklaratë se cilat klasa të kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor janë për investime nga sipërmarrja ose nënfondi furnizues;
  - b) Tarifat dhe shpenzimet që duhet të përballohen nga sipërmarrja ose nënfondi furnizues dhe detajet e çdo zbritje ose kthimi të tarifave ose shpenzimeve nga ana e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor;
  - c) Nëse është e aplikueshme, kushtet në të cilat kryhet çdo transferim fillestar ose pasardhës i aktiveve në natyrë nga sipërmarrja ose nënfondi furnizues te sipërmarrja ose nënfondi kryesor.
3. Dispozitat në lidhje rregullat standarde të tregtimit:
- a) Koordinimi i shpërndarjes dhe kohës së procesit të llogaritjes së vlerës neto të aktiveve dhe publikimit të çmimeve të kuotave;
  - b) Koordinimi i transmetimit të urdhërave të tregtimit nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, rolin e çdo pale të tretë;
  - c) Sipas rastit, rregullat e nevojshme në lidhje me faktin se kuotat e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, ose të sipërmarrjes ose nënfondit furnizues janë të listuara ose tregtohen në një treg sekondar;
  - d) Kur është e nevojshme, masat e duhura për të garantuar pajtueshmërinë me kërkesat për shmangien e strategjisë së parashikimit të tregut, duke parandaluar mundësitë e arbitrazhit;
  - e) Nëse kuotat e sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues ose kryesor janë të shprehura në monedha të ndryshme, bazën për konvertimin e urdhërave të tregtimit;
  - f) Fazat e shlyerjes dhe detajet e pagesës për blerjet ose nënshkrimet dhe riblerjet ose shlyerjet e kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, duke përfshirë, nëse është rënë dakord ndërmjet palëve, kushtet në të cilat sipërmarrja ose nënfondi kryesor mund të ekzekutojë kërkesat për shlyerje nëpërmjet transferimit të aktiveve në natyrë për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues në përputhje me nenin 27 pika 5 shkronja b) dhe Ligjin, veçanërisht në rastin kur sipërmarrja ose nënfondi kryesor likuidohet, bashkohet me një sipërmarrje tjetër ose ndahet në dy ose më shumë sipërmarrje të tilla;
  - g) Procedurat për të garantuar që kërkesat dhe ankesat e mbajtësve të kuotave të trajtohen në mënyrë të përshtatshme;
  - h) Nëse dokumenti themelues i sipërmarrjes dhe prospekti i sipërmarrjes kryesore , i jep sipërmarrjes kryesore të drejta ose kompetenca të caktuara në lidhje me mbajtësit e kuotave, dhe kjo sipërmarrje zgjedh të kufizojë ose të heqë dorë nga ushtrimi i disa ose i të gjithave këtyre të drejtave dhe kompetencave në lidhje me sipërmarrjen ose nënfondin furnizues, duhet një deklaratë e kushteve sipas të cilave ndodh kjo.
4. Dispozitat në lidhje me rrethanat që ndikojnë në rregullat e tregtimit:
- a. Mënyrën dhe kohën e njoftimit nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor ose sipërmarrjes ose nënfondit furnizues të pezullimit të përkohshëm dhe rifillimit të riblerjes, shlyerjes, blerjes ose nënshkrimit të kuotave të saj; dhe

- b) Rregullat për njoftimin dhe korigjimin e gabimeve të çmimeve në sipërmarrjen ose nënfondin kryesor.
5. Dispozitat lidhur me rregullat standarde të raportit të auditimit:
- a. Nëse sipërmarrja furnizuese dhe sipërmarrja kryesore kanë të njëjtat vite financiare dhe kontabël, bashkërendimin e hartimit të raporteve të tyre të auditit;
  - b) Nëse sipërmarrja ose nënfondi furnizues dhe sipërmarrja ose nënfondi kryesor kanë vite të ndryshme financiare, duhen përcaktuar rregullat që sipërmarrja ose nënfondi furnizues të marrin informacionin e nevojshëm nga sipërmarrja ose nënfondi kryesor, çka do të mundësojë hartimin në kohë të raporteve periodike të auditit për sipërmarrjen ose nënfondin furnizues, dhe garancinë se audituesi i sipërmarrjes ose nënfondit kryesor të jetë në gjendje të hartojë një raport *ad-hoc* në datën e mbylljes të vitit kontabël të sipërmarrjes ose të nënfondit furnizues.
6. Dispozitat që lidhen me ndryshimet e rregullave në fuqi. Mënyra dhe afatet e dhënies së njoftimit:
- a. Nga shoqëria administruese e sipërmarrjes kryesore në lidhje me ndryshimet e propozuara dhe të implementuara të dokumentit themelues, të prospektit SIK dhe dokumentit të informacionit kryesor për investitorët, nëse këto detaje ndryshojnë nga rregullat standarde për njoftimin e mbajtësve të kuotave të përcaktuar në dokumentin themelues ose në prospektin e sipërmarrjes kryesore;
  - b) Nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor lidhur me planifikimin ose propozimin për mbyllje, bashkim ose ndarje;
  - c) Nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit furnizues ose kryesor, që ka ndaluar, ose do të ndalojë të përmbushë, kushtet e kualifikimit për të qenë përkatësisht një sipërmarrje ose nënfond furnizues ose kryesor;
  - d) Kur synohet zëvendësimi i shoqërisë administruese, depozitarit, audituesit, ose e ndonjë pale të tretë që ka për detyrë të kryejë funksionet e administrimit të investimeve ose të administrimit të rrezikut në lidhje me sipërmarrjen ose nënfondin furnizues ose kryesor;
  - e) Nga shoqëria administruese e sipërmarrjes ose nënfondit kryesor lidhur me ndryshime të tjera të rregullave standarde, që merr përsipër të ofrojë.

## SHTOJCA 2

### PËRMBAJTJA E RREGULLAVE TË BRENDSHME TË USHTRIMIT TË BIZNESIT

1. Përcaktimet në lidhje me konfliktet e interesit duhet të përmbajnë:
  - a) Rregullat e brendshme të ushtrimit të biznesit duhet të përfshijnë masat e duhura për të zbutur konfliktet e interesit që mund të lindin midis:
    - i. Sipërmarrjes ose nënfondit furnizues dhe sipërmarrjes ose nënfondit kryesor; ose
    - ii. Sipërmarrjes ose nënfondit furnizues dhe mbajtësve të kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit kryesor, deri në shkallën që këto nuk trajtohen mjaftueshëm nga masat që zbaton shoqëritë administruese të fondeve për të përmbushur kërkesat e dispozitave të listuara në shkronjën b) të kësaj pike.
  - b) Dispozitat e përmendura në shkronjën a), të kësaj pike janë:
    - i. Llojet e konfliktit: Konfliktet e interesit ndërmjet shoqërisë administruese të fondit, duke përfshirë personat kyç, personelin kyç, punonjësit dhe agjentët e shitjes ose agjentët e lidhur ose çdo person të lidhur me to drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nëpërmjet kontrollit dhe një investitori të sipërmarrjes; ose ndërmjet dy ose më shumë investitorëve të shoqërisë; ose që lindin ose mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërive administruese të fondeve, që ofrojnë shërbime në lidhje me marrëveshjet kryesor-furnizues përfshirë ato të shkaktuara nga marrja e incentivave nga palët e treta ose nga shpërblimet e veta të shoqërisë dhe strukturat e tjera nxitëse;
    - ii. Regjistrimi i konflikteve: Shoqëria administruese duhet të mbajë dhe të përditësojë rregullisht një regjistër lidhur me llojet e shërbimit ose aktiviteteve që kryen nga ose në emër të asaj shoqërie në të cilën konflikti i interesit që ka lindur përbën një rrezik të konsiderueshëm material të interesave të një ose më shumë investitorëve, ose që mund të lindin në rastin e një shërbimi apo aktiviteti në vijim;
    - iii. Politikat e konfliktit:
      - a. Shoqëria administruese të fondeve mban dhe përdor rregulla efektive organizative dhe administrative me qëllim të marrjes së të gjitha hapave të arsyeshëm për të identifikuar dhe parandaluar konfliktet e interesit që ndikojnë negativisht në interesat e investitorëve të saj.
      - b. Shoqëria administruese duhet të krijojë, të zbatojë dhe të mirëmbajë një politikë efektive të konflikteve të interesit, e cila përcaktohet me shkrim dhe është e përshtatshme për madhësinë, organizimin e shoqërisë, natyrën, shkallën dhe për kompleksitetin e veprimtarisë së saj.
      - c. Nëse shoqëria administruese është anëtare e një grupi financiar, politika duhet gjithashtu të marrë në konsideratë çdo rrethanë, për të cilën shoqëria është ose duhet të jetë në dijeni, e cila mund të shkaktojë konflikt interesi si rezultat i strukturës dhe i aktiviteteve të biznesit që ushtrojnë anëtarë të tjerë të grupit.
    - iv. Politika e konfliktit të interesit ka përmbajtjen e mëposhtme:

- a. Identifikon rrethanat të cilat përbëjnë ose ka të ngjarë të shkaktojnë konflikt interesi, që sjellin një rrezik të konsiderueshëm material të interesave të një ose më shumë klientëve referuar shërbimeve dhe aktiviteteve specifike të kryera nga ose në emër të shoqërisë administruese; dhe
- b. Përcakton procedurat që duhet të ndiqen dhe masat që duhet të merren për të menaxhuar këto konflikte
- c. Procedurat dhe masat e parashikuara në shkronjën b) të kësaj pike përmbushin kriteret sa më poshtë:
  - i. Hartohen që të garantojnë se personat përkatës të angazhuar në aktivitete të ndryshme të biznesit të cilat përfshijnë konflikt interesi si ato të përcaktuara në shkronjën a), të kësaj pike, t'i kryejnë këto aktivitete në nivel pavarësie, në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e shoqërisë administruese ose të grupit të cilit i përkasin respektivisht, si dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë e rrezikut të dëmtimit të interesave të investitorëve;
  - ii. Kanë procedura efektive për parandalimin ose monitorimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet personave përkatës të angazhuar në aktivitete që përfshijnë rrezikun e konfliktit të interesit, kur shkëmbimi i atij informacioni mund të dëmtojë interesat e një ose më shumë investitorëve;
  - iii. Garantojnë mbikëqyrje të veçantë të personave përkatës, funksionet kryesore të të cilëve përfshijnë kryerjen e aktiviteteve në emër të investitorëve, ose ofrimin e shërbimeve për investitorët, interesat e të cilëve mund të bien ndesh ose përfaqësojnë interesa të ndryshme që mund të bien ndesh, përfshirë ato të shoqërisë;
  - iv. Eliminimi i çdo lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërblimit të personave përkatës të angazhuar kryesisht në një aktivitet dhe shpërblimit ose të ardhurave të gjeneruara nga persona të ndryshëm përkatës të angazhuar kryesisht në një aktivitet tjetër, ku mund të lindë konflikt interesi në lidhje me këto aktivitete;
  - v. Vendosija e masave për të parandaluar ose kufizuar çdo person që të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm mbi mënyrën se si një person përkatës kryen shërbime ose aktivitete;
  - vi. Vendosija e masave për të parandaluar ose kontrolluar përfshirjen e njëkohshme ose të njëpasnjëshme të një personi përkatës në shërbime ose aktivitete të veçanta, ku një përfshirje e tillë mund të ndikojë në administrimin e duhur të konflikteve të pikës iii., të kësaj shkronje;
  - vii. Nëse marrja ose përdorimi i një ose më shumë prej këtyre masave dhe procedurave nuk garanton nivelin e duhur të pavarësisë, shoqëria administruese e fondit duhet të marrë masa dhe procedura të tjera alternative ose shtesë që janë të nevojshme dhe të përshtatshme për qëllimet e shkronjës b. të kësaj pike.

- d. Në hartimin e politikës së konfliktit të interesit që identifikon rrethanat që përbëjnë ose mund të shkaktojnë konflikt interesi, shoqëria administruese e fondeve duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë aktiviteteve të këshillimeve në investimeve, transaksioneve të kuotave, menaxhimit të portofolit dhe *corporate finance*, duke përfshirë nënshkrimin ose shitjen në ofertën e titujve dhe këshillimin për bashkimet dhe blerjet nëpërmjet marrjes në kontroll. Më specifikisht, një kujdes i veçantë është i përshtatshëm kur shoqëria ose personi i lidhur me lidhje pronësie me shoqërinë administruese të fondeve kryen kombinimin e dy ose me shume prej këtyre aktiviteteve.
2. Kërkesa të tjera për shoqërinë administruese të fondit: Shoqëria administruese e fondeve, gjatë identifikimit të llojeve të konfliktit të interesave për qëllimet e pikës 1 të kësaj Shtojce, duhet të marrë në konsideratë interesat e veta, duke përfshirë ato që rrjedhin nga përkatësia e saj në një grup ose nga kryerja e shërbimeve dhe aktiviteteve, interesat e investitorëve dhe detyrimet e shoqërisë ndaj sipërmarrjeve; dhe nëse administrojnë dy ose më shumë sipërmarrje, interesat e të gjithë këtyre.
3. Struktura dhe organizimi i shoqërisë administruese: Shoqëria administruese të fondeve duhet të strukturohet dhe të organizohet në mënyrë të tillë që të minimizojë rrezikun që interesat e një sipërmarrjeje ose investitori të dëmtohen nga konfliktet e interesit ndërmjet shoqërisë administruese të fondit dhe investitorëve të saj, ndërmjet dy investitorëve të saj, ndërmjet një prej investitorëve të saj dhe sipërmarrjeve ose nënfondeve që administrohen prej saj, ose ndërmjet dy sipërmarrjeve ose nënfondeve të tilla.
4. Shoqëria administruese e fondeve duhet të përpiqet të shmangë konfliktet e interesit dhe, kur ato nuk mund të shmangen, të garantojë që skemat e sipërmarrjes që ajo administrojnë trajtohen në mënyrë të drejtë.
5. Nëse rregullat organizative ose administrative të ndërmarra nga shoqëria administruese e fondeve për menaxhimin e konfliktit të interesit nuk janë të mjaftueshme për të garantuar, me gjykim të arsyeshëm, parandalimin e rreziqeve të cenimit të interesave të sipërmarrjeve ose nënfondeve që administrojnë ose të mbajtësve të tyre të kuotave, atëherë ajo njofton menjëherë personat kyç të shoqërisë administruese të fondeve, në mënyrë që ata të marrin vendimet e domosdoshme për të garantuar që në të gjitha rastet, shoqëria të veprojë në interesin më të mirë të sipërmarrjes dhe të mbajtësve të saj të kuotave.
6. Shoqëria administruese e fondeve raporton situatat e përmendura në pikën 1, shkronjat a) ose b) të kësaj Shtojce të mbajtësit e kuotave të sipërmarrjeve ose nënfondeve që administrojnë nëpërmjet çdo mjeti komunikimi të përshtatshëm të qëndrueshëm dhe jep arsyet për vendimin e tij.